

VENDIMET E MBLEDHJES SË BORDIT 01 QERSHOR 2022

Vendimi Nr. 2022-019

Ball Kids dhe Referet në BJKC dhe Davis Cup 2022

- Bordi me shumicë votash miraton ftesën e Klubit të Tenisit Bellvue për dërgimin e tenistëve si Ball Kids dhe referëve në eventet BJKC dhe Davis Cup 2022 në Ulqin.
- Fëmijët 6-8 për event do të përzgjidhen nga trajneri nacional Arian Ibrahimimi i cili do të udhëtojë bashkë me fëmijët dhe trajnerën Viola Peja në ngjarje, ndërkaq referët do të përzgjidhen nga KRTK.
- Klubi Bellvue do të ofrojë qëndrim falas (akomodim, ushqim) për tenistët dhe referët nga Kosova, ndërsa FTK do të mbulojë pjesën tjetër të shpenzimeve rreth transportit dhe mëditjeve, sipas rregullores #03.

Vendimi Nr. 2022-020

Pajisja e FTK-së me depo/garazh me qera

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimin e Kryetari Jeton Hadërgjonaj për marrjen e një depo/garazh me qera për vendosjen e pajisjeve sportive (rekuizitave) të FTK-së, për të cilën administrata do të angazhohet për gjetjen e lokacionit të përshtatshëm dhe me kosto të përballueshme.

Vendimi Nr. 2022-021

Aktiviteti Training Week by TE, Prostevoj- Qeki

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimin e Drejtorit për Zhvillim për dërgimin e tenistëve Salidin Rama dhe Learta Muharremi në Training Week që organizohet nga Tennis Europe për grupmoshën U14, në Prostevoj – Qeki.
- Kampi (akomodimi dhe ushqimi, dhe trajnimi) për 2 tenistë ofrohet falas nga Tennis Europe, ndërsa FTK do të mbulojë shpenzimet e fluturimit, vizave për tenistët dhe trajnerin si dhe koston për pjesëmarrjen e trajnerit prej 500 EUR.
- Me tenistët do të udhëtojë selektori përkatës i U14 Arian Ibrahimimi.

Vendimi Nr. 2022-022

Zëvendësimi i Sekretares Fjolla Ibishi gjatë pushimit të Lehonisë

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimin e Kryetarit Hadërgjonaj për kontaktimin e Komsionerës Benita Selmanaj për të zëvendësuar pozitën e Sekretares gjatë pushimit të saj të lehonisë.

Vendimi Nr. 2022-023

Komisioni Disiplinor për ngjarjet e fundit me referin Sami Ukëhaxhaj dhe trajnerin Durim Morina

- Bordi me shumicë votash merr vendim të formohet një Komision Disiplinor për trajtimin e ankesave të fundit të pranuar rreth referit Sami Ukëhaxhaj dhe trajnerit Durim Morina.
- Një komision disiplinor prej 3 anëtarësh (njëri prej tyre në rangun e anëtareve të bordit) do të formohet ditëve në vijim nga administrata të cilët do të trajtojnë 2 ngjarjet e sipërpërmendura.

Vendimi Nr. 2022-024

Plotësimi i rregullores 03

- Bordi me shumicë votash merr vendim për ndryshimet e poshtëpërmendura në rregulloren 03 për financat, procedurat dhe rregullat:
 - 1) Klubet të cilat nuk i stimulojnë dhe sjellin tenistët në garat e FTK-së, nuk mund të përfitojnë përkrahje nga federata.
 - 2) Trajnerët të cilët nuk i stimulojnë dhe sjellin tenistët e tyre në garat e FTK-së, nuk mund të përfitojnë përkrahje nga federata.
 - 3) Tenistët që marrin përkrahje nga sponsorizimet mbi vlerën 1,000 euro nuk do të gëzojnë përkrahje edhe nga buxheti i FTK-së.